



Ambasada
e Republikës Federale të Gjermanisë
Tiranë



Tiranë, 28.09.2016

DEKLARATË SHTYPI

Vit jubilar i „Tetorit Gjerman“

Tetori Gjerman 2016 po pret publikun jo vetëm me një program të ngjeshur dhe të larmishëm por ai ofron këtë vit dhe një përvjetor të vërtetë: Tashmë për të dhjetën herë rradhazi Ambasada Gjermane bashkë me partnerët e shumtë do të organizojnë Javët Gjermane në Shqipëri.

Një traditë që ka zënë vend në jetën kulturore shqiptaro-gjermane

„Ky përvjetor dëshmon se Tetori Gjerman është kthyer ndërkohë në një traditë të vërtetë, e cila ka zënë një vend solid në jetën kulturore shqiptaro-gjermane“, tha Ambasadorja Gjermane Susanne Schütz gjatë prezantimit të programit më 28 shtator 2016 në Ambasadën Gjermane. „Edhe këtë vit ia kemi dalë mbanë të organizojmë bashkë me partnerë të shumtë një program, i cili tregon shtrirjen e gjerë të marrëdhënieve kulturore shqiptaro-gjermane“.

„Ky është vit përvjetorësh, si për Tetorin Gjerman edhe për Telekom Albania, dhe ne jemi sërish mbështetës të Javëve Gjermane në Shqipëri, të cilat sjellin vlerat më të mira të kulturës gjermane por paraqesin edhe një mundësi ideale për njohjen e artistëve tanë të rinj. Përkrahja e Telekom Albania përgjatë 10 viteve të Tetorit Gjerman në Shqipëri është një model i shkëlqyer bashkëpunimi, i cili mund të shtrihet edhe në fusha të tjera“, tha Ornela Bego nga Telekom Albania.

Përgjatë gjashtë javëve të ardhshme do të zhvillohen në Tiranë dhe në qytete të tjera të Shqipërisë aktivitete në kuadrin e Tetorit Gjerman. Programi është krijuar në mënyrë të tillë që të ofrojë diçka për shije dhe grupmosha të ndryshme. Muzika klasike dhe teatri janë po ashtu të përfaqësuar si dhe literatura, filmi dhe arti i grafitit. Përveç këtyre ka ekspozita dhe tryeza diskutimi për tema socio-politike.



ÇASTE QË NA LIDHIN.



TIRANA
BUSINESS
PARK



ProCredit Bank



Bayer HealthCare



Krombacher



KALO ASSOCIATES
ATTORNEYS AT LAW



Audi



Tirana International Airport
Nënë Tereza





Ambasada
e Republikës Federale të Gjermanisë
Tiranë



Theksi kryesor Shkëmbimi dhe Bashkëpunimi

Theksi kryesor vendoset tek projektet ndërkufitare, të cilat lidhin kulturën gjermane dhe shqiptare me njëra-tjetrën dhe sjellin bashkë krijuesit e kulturës nga të dy vendet.

I ftuar për shembull është kolektivi gjerman i krijuesve të të ashtuquajturit arti urban, „The Weird“, i cili në një workshop me pjesëmarrës shqiptarë do të trajtojë përpunimin e sipërfaqeve murale në hapësirat publike dhe do t'u japë formë artistike mureve të tjera.

Një premierë do të vijë edhe në fushën e teatrit: Qendra Goethe në Tiranë bashkë me regjizorin Stefan Çapaliku do të vë për herë të parë në skenën shqiptare pjesën teatrale „Nata arabe“ nga Roland Schimmelpfenig, një nga autorët bashkëkohorë i vënë më shpesh në skenat gjermane.

Tashmë është hera e dytë që Ambasada Gjermane fton në kuadrin e Tetorit Gjerman një shkrimtar gjerman për një qëndrim rezidencial në Tiranë. Autori Dorian Steinhoff nuk do të lexojë vetëm pjesë të shkëputura nga libri i tij por dhe do të organizojë bashkë me nxënës shqiptarë një prezantim të stilit Poetry-Slam.

Një qasje të veçantë ndaj muzikës klasike ofron duoja shqiptaro-gjermane Joel Blido (violinçel) dhe Marin Gjollma (piano). Në koncertet-bisedën e tyre në Tiranë dhe Korçë ata do të prezantojnë jo vetëm muzikën e dhomës në nivelin më të lartë por në prezantimin shoqërues do të shpjegohen gjithashtu dhe kontekstet historiko-muzikore.

Pjesë e programit do të jenë gjithashtu dhe „filma klasikë“ të vlerësuar. Katër ditë do të shfaqen me titra në shqip në Kinema Millennium filma gjermanë që kanë pasur sukses gjatë viteve të shkuara dhe pikërisht filmat: „Prindër“, „Detektivët e makaronave“, „About a girl“ dhe „Në labirintin e heshtjes“. Filma të tjerë do të jenë pjesë e programit në qytetet Korçë dhe Elbasan.

Programin e plotë të aktiviteteve mund ta gjeni në linkun: www.tetori-gjerman.com, në faqen e internetit të Ambasadës Gjermane www.tirana.diplo.de dhe në Facebook në llogarinë „[Ambasada Gjermane Tiranë](#)“.

Si çdo vit programi i Tetorit Gjerman është krijuar në bashkëpunim me partnerët gjermanë dhe shqiptarë dhe mundësohet nëpërmjet mbështetjes financiare bujare të sponsorëve të shumtë.

Christiane Wolters

Zëdhënëse e shtypit



ÇASTE QË NA LIDHIN.



TIRANA
BUSINESS
PARK



ProCredit Bank



Bayer HealthCare



Krombacher



KALO ASSOCIATES
ATTORNEYS AT LAW



Audi



Tirana International Airport
Nënë Tereza

